



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.597/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli, kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Vegim Ymerit, anëtar i vendvotimit nga Koalicioni AAK-NISMA , me seli Prishtinë, dega në Viti për shkak të parregullsive në vendvotim, gjatë ditës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.02.2025, mori këtë :

## V E N D I M

**HEDHET E PASAFATSHME** ankesa Anr.597/2025 datë 20.02.2025 e Vegim Ymerit, anëtar i vendvotimit nga Koalicioni AAK-NISMA , me seli Prishtinë, dega në Viti për shkak të parregullsive në vendvotim gjatë ditës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datë 20.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.597/2025 e dorëzuar në postë më datë 14.02.2025 nga Vegim Ymerit, anëtar i vendvotimit nga Koalicioni AAK-NISMA , me seli Prishtinë, dega në Viti me të cilën pretendohet se kjo ankesë ka të bëjë me dukurinë e “trenit bullgar”. Më tutje theksohet se pas mbylljes së vendvotimit është vërejtur se numri i nënshkrimeve nuk përputhej me numrin e votave në kuti dhe kryesuesi nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje propozoi që ai të nënshkruante në një rën nga hapësirat e zbrazëta në librin e votuesve (nënshkrimeve), në mënyrë që të barazonte numrat, por i njëjti nuk ka pranuar sepse tani do të bëhen dy parregullësi. Në vazhdim të ankesës u theksua se në librin e kryesuesit është cekur arsyeja pse nuk ka pranuar që të nënshkruaj procesin në fund, dhe ai mund të përdoret si provë.

Më tutje në ankesë si provë ka theksuar se janë të gjithë anëtarët e dhomës që kanë qenë dhe që e kanë parë dhe e kanë konstatuar këtë shkelje.

Paneli pas vlerësimit të ankesës, konstaton se :

**- Ankesa është e pasafatshme.**

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar në postë me letër rekomande R 6696660 ankesën me datë 14.02.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në vendvotim pas mbylljes së vendvotimit lidhur me mospërputhje të votave me nënshkrime të votuesve.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.02.2025, në ora 10:10, dhe e dorëzuar në postë më datë 14.02.2025 ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 09.02.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Vegim Ymerit, anëtar i vendvotimit nga Koalicioni AAK-NISMA, për shkak të parregullsive në vendvotim, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilin janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”,* si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.597/2025 datë 20.02.2025

Kryesues i Panelit,  
Kujtim Pasuli



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.